

1

Numri i kërkesave të parashtruara për mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese: **23**

Përgjigje të pranuar: Pozitive: **2** Negative: **5**¹ Nuk ka përgjigje: **17**

PËRMBAJTJA E PËRGJIGJEVE PAS KRYERJES SË MBIKËQYRJES SË JASHTËZAKONSHME INSPEKTUESE




- Përgjigje e dorëzuar vetëm me njoftim nga IShP-ja
- Përgjigje e dorëzuar me tërë dokumentacionin për mbikëqyrjen inspektuese

¹Në këtë periudhë, Komiteti i Helsinkit ka marrë përgjigje nga Inspektorati shtetëror i punës edhe për një kërkesë të dërguar më 22.10.2019. Kjo është arsyeja pse numri i përgjigjeve të pranuar është më i madh se numri i kërkesave të parashtruara për mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese.


2

NJËSITË RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË PUNËS, TE TË CILËT JANË PARASHTRUAR KËRKESAT PËR MBIKËQYRJE TË JASHTËZAKONSHME INSPEKTUESE:



3


LËNDË E MBIKËQYRJES INSPEKTUESE:




4

KOHA E PRITJES PËR MARRJEN E PËRGJIGJES LIDHUR ME KËRKESËN E PARASHTRUAR PËR MBIKËQYRJE TË JASHTËZAKONSHME INSPEKTUESE:

Koha e nevojshme për dorëzimin e përgjigjeve nga IShP lidhur me kërkesat e parashtruara për mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese



Koha e pritjes së përgjigjeve nga IShP lidhur me kërkesat për mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese për të cilat akoma nuk ka përgjigje



5

KONKLUDIME DHE REKOMANDIME:



1. Inspektorati shtetëror i punës edhe më tej **nuk po reagon shpejt dhe menjëherë** sa i përket kërkesave të parashtruara për mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese. Është i domosdoshëm një veprim i shpejtë dhe i menjëhershëm **për përmirësimin e efikasitetit në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve.**



2. Inspektorati shtetëror i punës për periudhën informuese, **në asnjë rast nuk e ka dorëzuar dokumentacionin e plotë nga mbikëqyrja e kryer inspektuese** (procesverbal për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese, aktvendim, urdhërpagesë dhe të ngjashme) deri te parashtruesi i kërkesave për mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese. Inspektorati duhet ta ndryshojë këtë praktikë nëse ka **për qëllim rritjen e transparencës në punën e tyre.**



3. Inspektorati shtetëror i punës, **akoma nuk vënë në përdorim linja funksionale të telefonit** në të gjitha njësitë rajonale. Kjo ndikon mbi **aksesin për mbrojtje dhe duhet që sa më shpejt të ndryshohet.**



4. Inspektorati shtetëror i punës duhet **të avancojë bashkëpunimin** me sindikatat, organizatën e punëdhënësve dhe të jetë më i hapur për bashkëpunim me organizatat qytetare.



5. Inspektorati shtetëror i punës duhet **më shpesh, në mënyrë më efektive dhe me vetiniciativë të kryejë mbikëqyrje kontrolluese** në rastet ku ka konstatuar shkelje të drejtave të punëtorëve dhe të kontrollojë nëse punëdhënësit i kanë zbatuar aktvendimet e Inspektoratit.



6. Inspektorati shtetëror i punës duhet **t'i njoftojë parashtruesit e kërkesave** për mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese lidhur me rezultatin e procedurave të iniciuara kundërvajtëse dhe shumën e sanksioneve të shqiptuara kundër punëdhënësve që nuk kanë zbatuar aktvendimet e Inspektoratit dhe të cilët nuk i kanë larguar shkeljet e konstatuara të drejtave të punëtorëve.



7. Inspektorati shtetëror i punës, akoma **nuk i ka implementuar shumicën e rekomandimeve të dhëna** në tabelat informuese të Komitetit të Helsinkit.